

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Sylta, në lëndën penale ndaj të pandehurit, F. G, për shkak të veprës penale,kanosja nga neni 185 paragrafi 2 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore-Departamenti për krime të përgjithëshme në Gjilan ,PP.II.nr.166/15, të dates 30.01.2015, pas mbajtjes së sencës së shqyrtimit gjyqësor dhe publik , në prezencën e të pandehurit dhe Prokurores së Shtetit, më 20.03.2017,shpalli publikisht, ndërsa më 28.03.2017,hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit F. G.nga baba I. dhe nëna I, e lindur R, i lindur më..., në K, me vendbanim në lagjen “, ka të kryer shkollën fillore, i punësuar, i martuar, prind i 2 (dy) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë, si dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale,ndaj tij,

konform nenit 363 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ,

REFUZOHET AKUZA

Sepse : më 24.01.2015, rreth orës 14:00 minuta , në fshatin ..të Komunës së Gjilanit, për shkak të mosmarrëveshjeve rreth një borgji, me fjalë dhe veprime e ka kanosur seriozisht të dëmtuarin F. Su nga fshati, në atrë mënyrë që te shtëpia e të dëmtuarit shkon së bashku me vëllain e tij dhe katër persona tjerë dhe prej tij kërkon që ta marrë ftohësin(llaktofrizin) të cilin ky dhe vëllai i tij më parë ia kishin dhënë për grumbullimin e qumshtit dhe pasi që i njejt refuzon të ia kthej këtë ftohës me pretendimin se këta i kishin borgj këtij të dëmtuari, i pandehuri i kanoset me fjalët”Nëse nuk e marr ftohësin, asnjë nuk gucon me dal jashtë shtëpisë se ju kalli, dynjaja nënën ma q... kështu që me këto fjalë dhe veprime te ky i dëmtuar ka shkaktuar ankth dhe frikë për shkak të cilave i njejt nuk e pengon më pas të njejtin që ta marrë llaktofrizin e vet,

me çka kishte për të kryer veprën penale, kanosja nga neni 185 paragrafi 2 i KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

Arsyetim

*Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti për krime të përgjithshme, ka ngritur aktakuzë ,PP.II.nr.166/2015, të datës 30.01.2015, kundër të pandehurit, F. G, për **shkak të veprës penale**, kanosja nga neni 185 paragrafi 2 i KPRK-së.*

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 20.07.2016, kanë prezentuar: Prokurorja e shtetit, Rozelida Hasani, pandehuri Fatmir Gashi si dhe i dëmtuari Flamur Surdulli.

Në këtë fazë të procedurës, i dëmtuari F. S,deklaron tërhiqem nga prpozimi i ndjekjes penale për të akuzuarin F. G.me arsyetimin se me te njejtin jemi pajtuar dhe se nuk kemi probleme, andaj vullnetarisht dhe me vetëdije të plotë e tërheq propozimin për ndjekje penale

Prokurorja e Shtetit Rozelida Hasani ,deklaroj pasi që i dëmtuari F. S, në seancën e shqyrtimit të sotëm gjyqësor,është tërhequr nga propozimi për ndjekje penale,ndaj të akuzuarit Fatmir Gashi , tërhiqem nga akuza me numër dhe datë të shenuar si më lartë.

Andaj , gjykata në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPRK-ës , Refuzon akuzën,ndaj të pandehurit Kreshnik Isufi.

Konform nenit 454 par.1 gjykata ka vendosur që shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.152/15, më 28.03.2017

Sekretarja juridike

Rafete Sylva,d.v

Gjyqtari

Islam Thaçi,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, ankesa i parashtrohet, Gjykatës së Apelit të Koosvës në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.